

VENDIM
Nr.790, datë 22.7.2009

**PËR SHPALLJEN “ZONË EKONOMIKE”, ME STATUSIN “PARK INDUSTRIAL”
NË LAKNAS, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4 të ligjit nr.9789, datë 19.7.2007 “Për krijimin dhe funksionimin e zonave ekonomike”, dhe të shkronjës “g” të pikës 1 të nenit 4, të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen zonë ekonomike, me status “Park industrial”, të sipërfaqes 9.48 (nëntë pikë dyzet e tetë), ha, në zonën rurale, në Laknas, Tiranë, shtrirja dhe kufizmet e së cilës specifikohen në hartën treguese, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
 2. Lloji i veprimtarisë, që do të zhvillohen në këtë zonë, është:
 - i) Veprimtari prodhuese, industriale;
 - ii) Veprimtari tregtare, import-eksport;
 - iii) Shërbime dhe magazinime.
 3. Periudha e funksionimit të kësaj zone ekonomike është 35 vjet.
 4. E drejta për krijimin, zhvillimin dhe veprimin e zonës ekonomike, me statusin “Park industrial”, jepet me koncesion, të formës “BOT” (ndërtim, operim, transferim).
 5. Procedura e përzgjedhjes së zhvilluesit të zonës bëhet në mbështetje të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar.
 6. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik dhe bashkia Kamëz për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PLAN RILEVIMI
SHKALLA 1:2500

ZONA KADASTRALE: 2372.83.20

NDEKSI I HARTES K-34-88-0233-QJ

SHKALLA 1:2500

ADRESA E PASTURISE: Rrethi I TIRANË

QF LAKNAS

*RONARET SAMIR MANE, AGIM ZEQQ

L1 = 51849 m²

L2 = 42952 m²



PER "ES-2" SHPK
Top. EDISON SINANAJ
Licenca Nr: N. 5020